



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL “SHËRBIME HIDRAULIKE NË UJËSJELLËS KANALIZIME”

Niveli III në KSHK¹, referuar nivelit IV të KEK²

V6-III-26

Tiranë 2026

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Përmbajtje

Emërtimi i kualifikimit	4
Kodi.....	4
Kohëzgjatja	4
Niveli.....	4
Kriteret e përgjithshme të pranimiit	4
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit	4
Ofruesit	4
Data e validimit.....	4
STRUKTURA E KUALIFIKIMIT.....	5
KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME	5
NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:	5
NjN-20-III-0586-26 Bazat e hidraulikës në ujësjellës kanalizime	6
Rezultatet e të nxënit në njohuri	6
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	6
Kriteret e vlerësimit	6
NjN-20-III-0587-26 Bazat e topografisë.....	7
Rezultatet e të nxënit në njohuri	7
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	7
Kriteret e vlerësimit	7
NjN-20-III-0588-26 Materialet në hidraulikë.....	8
Rezultatet e të nxënit në njohuri	8
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	9
Kriteret e vlerësimit	9
NjN-20-III-0589-26 Mjetet, veglat, pajisjet dhe makineritë e punës në hidraulikë.....	10
Rezultatet e të nxënit në njohuri	10
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	10
Kriteret e vlerësimit	10
NjN-20-III-0590-26 Planifikimi dhe organizimi i punës në ujësjellës kanalizime	11
Rezultatet e të nxënit në njohuri	11
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	12
Kriteret e vlerësimit	12
NjN-20-III-0591-26 Operimi dhe mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë dhe hidrantëve	12
Rezultatet e të nxënit në njohuri	13

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	13
Kriteret e vlerësimit	13
NjN-20-III-0592-26 Instalimi i sistemit të furnizimit me ujë dhe hidrantëve	14
Rezultatet e të nxënit në njohuri	14
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	15
Kriteret e vlerësimit	15
NjN-20-III-0593-26 Operimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura.....	15
Rezultatet e të nxënit në njohuri	16
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	16
Kriteret e vlerësimit	16
NjN-20-III-0594-26 Instalimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura	17
Rezultatet e të nxënit në njohuri	17
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	17
Kriteret e vlerësimit	17
NjN-20-III-0595-26 Operimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të ujërave të shiut	17
Rezultatet e të nxënit në njohuri	18
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	18
Kriteret e vlerësimit	18
NjN-20-III-0596-26 Instalimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të shiut	19
Rezultatet e të nxënit në njohuri	19
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	19
Kriteret e vlerësimit	19
NjN-24-III-0492-26 Sipërmarrje, komunikim dhe edukim karriere	20
Rezultatet e të nxënit në njohuri	20
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	21
Kriteret e vlerësimit	22
NjN-20-III-0597-26 Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në ujësjellës kanalizime	23
Rezultatet e të nxënit në njohuri	23
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	23
Kriteret e vlerësimit	24
Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:	24
Modalitetet e vlerësimit	25
Informacion shtesë	25
SHËNIM	26

Emërtimi i kualifikimit	“Shërbime hidraulike në ujësjellës kanalizime”			Kodi
Kohëzgjatja	3300-4500 orë nacionale	Niveli	III KSHK, referuar nivelit III të KEK,	V6-III-26
Qëllimi:	Qëllimi kryesor i kualifikimit profesional “Shërbime hidraulike në ujësjellës kanalizime”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, është <i>“zhvillimi i personalitetit të individit për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejtë me profilin</i> “Shërbime hidraulike në ujësjellës kanalizime”. Zhvillimi te individit i ndjenjës së vetëbesimit, kultivimi i vullnetit të lirë në marrjen e vendimeve, nxitja e gatishmërisë për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe për t’u zhvilluar individualisht në drejtimet emocionale, intelektuale dhe një shkallë të gjerë njohurish profesionale janë sfida të rëndësishme për arritjen e këtij qëllimi.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	Në shkollat që ofrojnë arsim profesional në kualifikimin “Shërbime hidraulike në ujësjellës kanalizime” niveli III në KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që: - kanë mbaruar arsimin e detyruar 9-vjeçar; - janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	Pas përfundimit me sukses të kualifikimit profesional “Shërbime hidraulike në ujësjellës kanalizime”, niveli III në KSHK, me kohëzgjatje 3 vite shkollore, pas përfundimit të arsimit bazë, individit pajiset me certifikatë profesionale të maturës shkollore profesionale dhe suplementin përkatës ose del në tregun e punës si punonjës i kualifikuar. Ky kualifikim i jep individit mundësinë që t’i drejtohet tregut të punës për punësim në sektorin e ndërtimit si: instalues i sistemeve hidraulike të furnizimit me ujë, shkarkimit të ujërave të ndotura, mbledhjes dhe shkarkimit të ujërave të reshjeve, të hidranteve të sistemit, si riparues dhe mirëmbajtës i sistemit të furnizimit me ujë dhe ujërave të ndotura. Gjithashtu, individit mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e veprimtarive hidraulike të përmendura më sipër. Gjithashtu, përfundimi i këtij niveli lejon kalimin në nivel më të lartë të arsimit profesional, në nivelin IV në KSHK, arsim profesional njëvjeçar (nivel teknik/menaxherial), me qëllim përfitimin e diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale” ose në kursin urë, të përgjithshëm, dhe pas përfundimit të njërit nga këto kualifikime mund të vazhdojë studime pas të mesme ose universitare.			
Ofruesit	Ky kualifikim duhet të ofrohet nga ofrues të akredituar në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.			
Data e validimit				
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme				

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Në përfundim të kualifikimit profesional në drejtimin “Shërbime hidraulike në ujësjellës kanalizime” niveli III në KSHK, referuar nivelit të III të KEK, individit duhet të zotërojë njohuritë, shprehjet profesionale dhe kompetencat e përgjithshme të ndara sipas njësive të të nxënës të mëposhtme:

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Rezultatet e të nxënës të kompetencave të përgjithshme janë të vlefshme për të gjitha njësitë e të nxënës.

1. Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet dhe ndjenjat e tij, si dhe për të argumentuar opinione për çështje të ndryshme;
2. Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme për mbledhjen dhe të shfrytëzimin e informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
3. Të nxisë potencialin e tij/saj të brendshëm në kërkimin e vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
4. Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
5. Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale dhe rajonale;
6. Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij/saj;
7. Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij/saj dhe të shfaqë gatishmëri dhe vullnet për të nxënë gjatë gjithë jetës;
8. Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të përbashkëta;
9. Të demonstrojë aftësi për të përmbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar;
10. Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij/saj;
11. Të marrë nisma për të bashkëpunuar me individë ose grupe;
12. Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtari shkollore, profesionale dhe komunitare;
13. Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për qenë pjesëmarrës pro aktiv në grup;
14. Të pranojë dhe të promovojë risitë dhe ndryshimet;
15. Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë veten, nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij/saj, për t'u përshtatur me evolucionin teknologjik.

NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:

Standardet e kualifikimit hartohen në bazë të rezultateve të të nxënës (kompetenca të përgjithshme, njohuri dhe shprehje profesionale).

NjN-20-III-0586-26 Bazat e hidraulikës në ujësjellës kanalizime

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë ciklin hidrologjik të ujit;
2. Të përshkruajë konceptin e hidraulikës, fushën e veprimtarisë dhe specializimet përkatëse;
3. Të identifikojë llojet e sistemeve hidraulike sipas përdorimit dhe funksionit të tyre;
4. Të përkufizojë lëngjet.
5. Të dallojë vetitë kryesore të lëngjeve në gjendje qetësie.
6. Të shpjegojë konceptin e presionit dhe njësitë matëse të tij.
7. Të përshkruajë mënyrën se si ndryshon presioni me thellësinë në lëngje.
8. Të shpjegojë Ligjin e Paskalit.
9. Të ilustrojë shembuj praktikë të Ligjit të Paskalit (p.sh. presa hidraulike, funksionimi i pajisjeve hidraulike).
10. Të shpjegojë Parimin e Arkimedit.
11. Të përshkruajë sjelljen e trupave në ujë (fundosje, notim).
12. Të përkufizojë rrjedhjen e lëngjeve.
13. Të dallojë rrjedhjen laminare nga ajo turbulente (në nivel përshkrues).
14. Të shpjegojë kuptimin e shpejtësisë së rrjedhjes dhe humbjeve.
15. Të përshkruajë në mënyrë të thjeshtë lidhjen ndërmjet seksionit të tubit dhe shpejtësisë së rrjedhjes (ekuacioni i vazhdimësisë).
16. Të identifikojë faktorët kryesorë që ndikojnë në rrjedhjen e lëngjeve (p.sh. diametri i tubit, pjerrësia, pengesat).
17. Të shpjegojë në mënyrë bazike lidhjen ndërmjet presionit, shpejtësisë dhe lartësisë së lëngut.
18. Të përshkruajë Ekuacionin e Bernulit me shembuj praktikë të thjeshtë (p.sh. rrjedhja në tub, spërkatës uji etj.).
19. Të ilustrojë përdorime praktike të parimit të Bernulit në jetën e përditshme dhe në profesion (instalime hidraulike bazë).
20. Të përshkruajë skema të thjeshta hidraulike.
21. Të identifikojë komponentët bazë të një sistemi hidraulik (tuba, valvula, pompa, hidrantë etj.).

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të identifikojë sistemet hidraulike sipas përdorimit, funksionit dhe fushës së zbatimit;
2. Të dallojë konceptet bazë të hidrostatikës dhe hidrodinamikës;
3. Të kryejë llogaritje të parametrave kryesorë të lëngjeve (presionin, shpejtësinë e rrjedhjes, lartësinë), duke përdorur njësitë e matjes në sistemin SI;
4. Të demonstrojë zbatimin e Ligjit të Paskalit;
5. Të interpretojë Ekuacionin e Vazhdueshmërisë dhe Ekuacionin e Bernulit në rrjedhjen e lëngjeve;
6. Të lexojë skema të thjeshta hidraulike sipas kushteve teknike;
7. Të identifikojë komponentët bazë të sistemeve hidraulike (tuba, valvula, pompa, hidrantë etj.) sipas funksionit të tyre.

Kriteret e vlerësimit

- Identifikon saktë llojet e sistemeve hidraulike sipas përdorimit dhe funksionit të tyre;
- Dallon hidrostatikën nga hidrodinamika;
- Demonstron vetitë kryesore të lëngjeve në gjendje qetësie përmes shembujve praktikë;
- Mat saktë presionin duke përdorur njësitë përkatëse matëse.

- Demonstron zbatimin e Ligjit të Paskalit në një situatë praktike;
- Mat shpejtësinë e rrjedhjes së lëngjeve;
- Interpretton ekuacionin e vazhdueshmërisë;
- Interpretton ekuacionin e Bernulit;
- Ilustron praktikisht Ekuacionin e Bernulit në shembuj të thjeshtë funksionalë;
- Demonstron përdorime praktike të parimit të Bernulit në instalime hidraulike bazë;
- Interpretton lidhjen ndërmjet presionit, shpejtësisë dhe lartësisë në rrjedhjen e lëngjeve;
- Krahason rrjedhjen laminare dhe turbulente, në shembuj praktikë.
- Përdor saktë njësitë e matjes, në sistemin SI;
- Lexon, interpretton dhe vizaton saktë skema të thjeshta hidraulike;
- Identifikon komponentët bazë të një sistemi hidraulik, sipas funksionit të tyre.

NjN-20-III-0587-26 Bazat e topografisë

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë çfarë është topografia dhe përdorimin e saj në ndërtim;
2. Të shpjegojë çfarë janë izohipset (vijat e nivelit);
3. Të shpjegojë se çfarë tregojnë izohipset në një hartë;
4. Të identifikojë ndryshimet në terren (pjerrësi, kodra, lugina) duke parë izohipset;
5. Të shpjegojë çfarë janë kuotat (lartësitë);
6. Të shpjegojë kuptimin e nivelit zero dhe referencës së lartësisë;
7. Të shpjegojë në mënyrë të thjeshtë konceptin e rievimi topografik;
8. Të identifikojë instrumentet bazë të matjes në topografi (p.sh. niveli, metri, shkopi i nivelimit etj.);
9. Të shpjegojë mënyrën e mbledhjes së të dhënave nga terreni për hartimin e një plani të thjeshtë topografik;
10. Të shpjegojë rëndësinë e saktësisë në matje topografike;
11. Të shpjegojë pasojat që mund të sjellin gabimet në matje.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të interpretojë konceptet bazë të topografisë, përdorimet e saj në ndërtim dhe elementet kryesore të hartave topografike;
2. Të interpretojë izohipset, kuotat (absolute dhe relative) dhe lidhjen e tyre me formën e terrenit;
3. Të analizojë elementët e relievit të terrenit (pjerrësi, kodra, lugina) bazuar në izohipse dhe kuota;
4. Të dallojë paraqitjen planimetricë nga ajo altimetricë në plane dhe harta topografike;
5. Të lexojë dhe interpretojë të dhënat nga terreni për hartimin ose leximin e një plani të thjeshtë topografik;
6. Të interpretojë izohipse të thjeshta bazuar në të dhënat e matjeve topografike;
7. Të përdorë instrumentet bazë të matjes dhe rievimit topografik (niveli, metri, niveli matës etj.).

Kriteret e vlerësimit

- Shpjegon saktë konceptin e topografisë dhe përdorimet e saj në punimet e ndërtimit;
- Identifikon saktë izohipset në harta ose plane topografike;
- Përcakton saktë pjerrësitë, kodrat dhe luginat duke analizuar izohipset në hartë;
- Interpretton saktë informacionin që paraqesin izohipset në një hartë topografike;
- Lexon kuotat nga një plan ose hartë;
- Lexon dhe interpretton saktë kuotat (lartësitë) në një plan ose hartë topografike;
- Dallon saktë paraqitjen planimetricë nga ajo altimetricë;

- Shpjegon lidhjen midis izohipseve dhe formës së terrenit;
- Mbledh saktë të dhënat nga terreni për hartimin e një plani të thjeshtë topografik;
- Interpretin saktë një plan të thjeshtë bazuar në të dhënat e terrenit;
- Interpretin bazat e hartave topografike;
- Identifikon dhe përdor saktë instrumentet bazë të matjes dhe rievimit topografik (niveli, metri, niveli matës etj.);
- Përdor saktë instrumentet bazë të matjes topografike (nivel, metër, nivel matës).
- Zbaton standardet e saktësisë gjatë matjeve topografike;
- Harton izohipse të thjeshta bazuar në të dhënat e matjeve;
- Kryen matjet bazë në terren (distanca dhe nivele);
- Përdor korrekt mjetet bazë të rievimit.
- Identifikon pasojat e gabimeve në matje gjatë veprimtarive praktike topografike.
- Analizon pasojat e gabimeve në matje gjatë veprimtarive praktike topografike;
- Kryen rievim të thjeshtë topografik të pushtave;

NjN-20-III-0588-26 Materialet në hidraulikë

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të identifikojë llojet e materialeve që përdoren në hidraulikë (Gres, Beton, b/a, xingato, DCI, çelik, PE, PVC etj.)
2. Të identifikojë llojet e materialeve që përdoren në sistemin e furnizimit me ujë (FU);
3. Të identifikojë llojet e materialeve që përdoren në rrjetin e kanalizime të ujrave të ndotura (KUN)
4. Të identifikojë llojet e materialeve që përdoren në rrjetin e kanalizimeve të ujrave të shiut (KUSH);
5. Të shpjegojë klasifikimin e materialeve sipas përdorimit në rrjetet e ujës-jellësit dhe kanalizimeve;
6. Të identifikojë materialet ndihmëse për kryerjen e proceseve të punës (letër zmeril ,fije lini,pastë lubrifikuese.).
7. Të identifikojë llojet e rakorderive hidraulike;
8. Të interpretojë skedat teknike të materialeve;
9. Të shpjegojë mënyrat e bashkimit të materialeve të njëjta dhe të ndryshme midis tyre.
10. Të shpjegojë kriteret për përzgjedhjen e materialeve sipas presionit, diametrit, funksionit dhe kushteve të terrenit;
11. Të identifikojë specifikimet teknike sipas llojit të materialit.
12. Të identifikojë standardet dhe normat teknike që lidhen me materialet hidraulike;
13. Të përshkruajë klasifikimin e tubacioneve sipas diametrit, presionit dhe destinacionit të përdorimit;
14. Të identifikojë elementët e sigurisë gjatë transportit, magazinimit dhe përdorimit të materialeve hidraulike;
15. Të shpjegojë ndikimin e faktorëve mjedisorë në jetëgjatësinë e materialeve (lagështia, temperatura, korrozioni, ekspozimi kimik);
16. Të identifikojë simbolet dhe shenjat teknike që përdoren në dokumentacionin e materialeve hidraulike;
17. Të përshkruajë kërkesat bazë për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve dhe pajisjeve hidraulike.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të identifikojë materialet që përdoren në sistemet hidraulike, furnizimin me ujë (FU), kanalizimet e ujërave të ndotura (KUN) dhe kanalizimet e ujërave të shiut (KUSH) sipas karakteristikave dhe përdorimit të tyre;
2. Të përdorë materialet bazë hidraulike në proceset e punës;
3. Të përdorë materialet ndihmëse hidraulike në proceset e punës;
4. Të interpretojë skadat teknike, specifikimet teknike dhe simbolet e dokumentacionit të materialeve hidraulike;
5. Të zbatojë teknikat bashkimit të materialeve të njëjta dhe të ndryshme sipas standardeve dhe procedurave teknike;
6. Të kontrollojë cilësinë dhe gjendjen fizike të materialeve përpara përdorimit në procesin e punës;
7. Të organizojë materialet hidraulike sipas kushteve teknike dhe procedurave përkatëse.

Kriteret e vlerësimit

- Identifikon saktë materialet që përdoren në hidraulikë sipas karakteristikave dhe përdorimit të tyre;
- Identifikon saktë materialet që përdoren në sistemet e furnizimit me ujë (FU);
- Identifikon saktë materialet që përdoren në rrjetet e kanalizimeve të ujërave të ndotura (KUN);
- Identifikon saktë materialet që përdoren në rrjetet e kanalizimeve të ujërave të shiut (KUSH);
- Përzgjedh saktë materialet sipas funksionit në rrjetet e ujësjellësit dhe kanalizimeve.
- Identifikon saktë materialet ndihmëse gjatë proceseve të punës (letër zmeril, fije lini, pastë lubrifikuese etj.);
- Përdor saktë materialet ndihmëse gjatë proceseve të punës (letër zmeril, fije lini, pastë lubrifikuese etj.);
- Identifikon saktë rakorderitë hidraulike sipas funksionit dhe përdorimit;
- Përzgjedh rakorderitë e duhura sipas tipit të tubacionit dhe funksionit të instalimit;
- Lexon dhe interpreton saktë skadat teknike të materialeve hidraulike;
- Zbaton saktë mënyrat e bashkimit të materialeve të njëjta dhe të ndryshme sipas procedurave teknike;
- Përzgjedh saktë materialet bazuar në precesin e punës, diametrin, funksionin dhe kushtet e terrenit;
- Verifikon saktë specifikimet teknike të materialeve përpara përdorimit;
- Zbaton standardet dhe normat teknike gjatë përzgjedhjes dhe përdorimit të materialeve hidraulike;
- Klasifikon saktë tubacionet sipas diametrit, presionit dhe destinacionit të përdorimit;
- Zbaton rregullat e sigurisë gjatë transportit të materialeve hidraulike;
- Zbaton procedurat e duhura gjatë magazinimit të materialeve dhe pajisjeve hidraulike;
- Përdor në mënyrë të sigurt materialet hidraulike gjatë proceseve të punës;
- Identifikon ndikimin e lagështisë në cilësinë e materialeve hidraulike;
- Identifikon ndikimin e temperaturës në performancën e materialeve hidraulike;
- Identifikon dhe vlerëson efektet e korrozionit në materialet metalike;
- Dallon ndikimin e ekspozimit kimik në jetëgjatësinë e materialeve;
- Lexon dhe interpreton saktë simbolet teknike në dokumentacionin e materialeve hidraulike;
- Organizon saktë ruajtjen e materialeve sipas kushteve teknike;
- Kontrollon gjendjen fizike të materialeve para përdorimit në punë;
- Krahason materiale të ndryshme duke argumentuar zgjedhjen më të përshtatshme për një situatë konkrete pune;

NjN-20-III-0589-26 Mjetet, veglat, pajisjet dhe makineritë e punës në hidraulikë

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë llojet e mjeteve dhe veglave të punës në UK (bisturi, metër, nivel, sharrë etj.) dhe mënyrën e përdorimit të tyre;
2. Të shpjegojë rëndësinë e parapërgatitjes së tubacioneve dhe rakorderive për instalim (matje, prerje, zmerilim etj.)
3. Të shpjegojë karakteristikat e mjeteve dhe veglave të punës në UK;
4. Të shpjegojë pajisjet e punës në UK (gjenerator, saldatriçe etj.) dhe mënyrën e përdorimit të tyre;
5. Të shpjegojë karakteristikat e pajisjeve të punës në UK.
6. Të shpjegojë rëndësinë e leximit dhe zbatimit të skedave teknike dhe manualeve të përdorimit;
7. Të shpjegojë funksionimin dhe përdorimin e mjeteve, dhe pajisjeve të punës;
8. Të shpjegojë funksionin dhe rëndësinë e përzgjedhjes së makinerive (Pick Up ,Vacum truck, fadromë, tricikël etj.) sipas llojit të punës;
9. Të shpjegojë rëndësinë e inspektimeve vizuale dhe atyre me kamera CCTV për të identifikuar çarjet, bllokimet ose rrënjët e pemëve;
10. Të shpjegojë klasifikimin e mjeteve, veglave, pajisjeve dhe makinerive sipas funksionit dhe llojit të punës;
11. Të identifikojë kriteret për përzgjedhjen e mjeteve dhe pajisjeve sipas materialit, diametrit të tubacionit dhe natyrës së ndërhyrjes;
12. Të shpjegojë procedurat bazë të kontrollit teknik para përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve;
13. Të përshkruajë procedurat e mirëmbajtjes rutinë të mjeteve, pajisjeve dhe makinerive të punës;
14. Të identifikojë defektet më të zakonshme të mjeteve dhe pajisjeve gjatë punës;
15. Të shpjegojë masat e sigurisë gjatë përdorimit të veglave manuale, pajisjeve elektrike dhe makinerive të rënda;
16. Të përshkruajë pajisjet matëse dhe kontrolluese që përdoren për verifikimin e parametrave të sistemit (presion, rrjedhje, nivel etj.);
17. Të shpjegojë procedurat e pastrimit dhe ruajtjes së mjeteve dhe pajisjeve pas përdorimit;
18. Të identifikojë pajisjet e mbrojtjes personale (PPE) që përdoren gjatë operimit me makineri dhe pajisje;
19. Të shpjegojë përdorimin e teknologjive bashkëkohore në inspektimin dhe mirëmbajtjen e rrjeteve (kamera inspektimi, pajisje për zbulimn e rrjedhjeve etj.).

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të përdorë mjetet dhe veglat e punës sipas funksionit dhe llojit të ndërhyrjes në sistemet UK;
2. Të kryejë parapërgatitjen e tubacioneve dhe rakorderive për instalim përmes matjes, prerjes, zmerilimit dhe proceseve të tjera përgatitore sipas kushteve teknike;
3. Të përdorë pajisjet e punës sipas karakteristikave teknike, materialit dhe diametrit të tubacionit;
4. Të zbatojë skedat teknike, manualët e përdorimit dhe udhëzimet teknike gjatë proceseve të punës;
5. Të përzgjedhë makineritë e punës sipas natyrës së ndërhyrjeve në rrjetet e ujësjellës-kanalizimeve;
6. Të kryejë kontrollin teknik bazë, mirëmbajtjen rutinë, pastrimin dhe ruajtje të mjeteve, pajisjeve dhe makinerive sipas procedurave përkatëse;
7. Të përdorë teknologji moderne të inspektimit dhe diagnostikimit (kamera CCTV, pajisje për zbulimin e rrjedhjeve etj.) për identifikimin e problemeve në rrjet;

Kriteret e vlerësimit

- Identifikon saktë mjetet dhe veglat manuale të punës në UK sipas funksionit të tyre;
- Përdor saktë mjetet manuale gjatë proceseve të punës sipas procedurave teknike;
- Përzgjedh mjetin e duhur sipas llojit të punës që duhet kryer;
- Mat saktë tubacionet përpara procesit të instalimit;
- Kryen saktë prerjen e tubacioneve sipas pwrmasave të kërkuara;
- Kryen saktë zmerilimin dhe parapërgatitjen e tubacioneve dhe rakorderive për instalim;
- Identifikon saktë pajisjet e punës (gjenerator, saldatriçe etj.) sipas funksionit të tyre;
- Përdor saktë pajisjet e punës sipas manualeve dhe procedurave teknike;
- Verifikon gjendjen teknike të pajisjeve përpara përdorimit;
- Lexon dhe interpreton saktë skadat teknike dhe manualët e përdorimit;
- Zbaton udhëzimet teknike gjatë përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve;
- Identifikon saktë makineritë e punës sipas funksionit (Pick Up, Vacuum Truck, fadromë etj.);
- Përzgjedh makinerinë e duhur sipas natyrës së ndërhyrjes në rrjet;
- Përdor kamerat e inspektimit (CCTV) për evidentimin e çarjeve, bllokimeve dhe pengesave në rrjet;
- Përzgjedh pajisjet e duhura sipas materialit dhe diametrit të tubacionit;
- Kryen kontroll teknik bazë të mjeteve dhe pajisjeve para përdorimit;
- Identifikon defektet më të zakonshme gjatë përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve;
- Raporton defektet e evidentuara të mjeteve dhe pajisjeve tek përgjegjësi përkatës;
- Kryen mirëmbajtje rutinë të mjeteve dhe pajisjeve sipas procedurave;
- Pastron saktë mjetet dhe pajisjet pas përdorimit;
- Organizon dhe ruan saktë mjetet dhe pajisjet në vendet përkatëse;
- Përdor pajisjet matëse për kontrollin e presionit, prurjes dhe nivelit;
- Lexon saktë rezultatet e pajisjeve matëse;
- Përdor pajisjet e mbrojtjes personale (PPE) sipas rregullave të sigurisë;
- Zbaton masat e sigurisë gjatë përdorimit të veglave manuale;
- Zbaton masat e sigurisë gjatë përdorimit të pajisjeve elektromekanike;
- Zbaton masat e sigurisë gjatë operimit me makineri të rënda;
- Përdor pajisje bashkëkohore për zbulimin e rrjedhjeve në rrjet;
- Përdor pajisje moderne inspektimi për diagnostikimin e problemeve në sistemet UK;
- Kryen inspektimin vizual dhe me kamera (CCTV) për identifikim të çarjeve, bllokimeve ose depërtimit të rrënjëve të pemëve;

NjN-20-III-0590-26 Planifikimi dhe organizimi i punës në ujësjellës kanalizime

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të kuadrit rregullator për shërbimet e brendshme në UK;
2. Të shpjegojë rëndësinë e ndarjes së detyrave sipas hierarkisë në procesin e punës;
3. Të identifikojë simbolet e përdorura në skicat teknike dhe projekte;
4. Të përshkruajë përmbajtjen dhe rëndësinë e planit të punës dhe grafikut të punimeve;
5. Të klasifikojë llojet e punimeve sipas natyrës dhe kërkesave të zbatimit;
6. Të përshkruajë mënyrat e zhvillimit të punimeve në varësi të terrenit dhe kushteve të objektit;
7. Të shpjegojë rëndësinë e njohjes paraprake të vendit dhe objektit ku do të kryhen punimet;
8. Të shpjegojë grafikun e mirëmbajtjes, elementet përbërëse dhe rëndësinë e zbatimit të tij;
9. Të shpjegojë llojet e shiritave sinjalizues.
10. Të identifikojë kërkesat teknike për vendosjen e shiritit sinjalizues mbi tubacion;
11. Të përshkruajë mënyrat e organizimit të vendit të punës;

12. Të përshkruajë mënyrat e transportimit të materialeve, mjeteve, veglave dhe pajisjeve gjatë punës;
13. Të shpjegojë rëndësinë e transportimit të sigurt të mjeteve, materialeve dhe pajisjeve;
14. Të përshkruajë mënyrat e pastrimit dhe sistemimit të veshjeve, mjeteve dhe vendit të punës para, gjatë dhe pas përfundimit të punës;
15. Të shpjegojë rëndësinë e ruajtjes së pastërtisë dhe rregullit në vendin e punës;
16. Të shpjegojë rëndësinë e njoftimit të eprorit për defekte apo avaritë e konstatuara;
17. Të përshkruajë rëndësinë e dokumentimit dhe raportimit për punën e kryer;
18. Të përshkruajë rëndësinë e bashkëpunimit dhe komunikimit në grup gjatë organizimit të punës.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë planin e punës;
2. Të zbatojë grafikun e punimeve brenda afateve të përcaktuara;
3. Të interpretojë simbolet e përdorura në skica dhe projekte teknike;
4. Të planifikojë punimet në varësi të terrenit dhe kushteve të objektit;
5. Të ndjekë transportimin e materialeve, mjeteve, veglave dhe pajisjeve sipas kërkesave të punës;
6. Të kryejë pastrimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve, veglave dhe pajisjeve;
7. Të organizojë vendin e punës para fillimit të punimeve;
8. Të bashkëpunojë në grup për kryerjen e detyrave;
9. Të dokumentojë dhe raportojë punën e kryer.

Kriteret e vlerësimit

- Respekton kuadrin rregullator të shërbimeve të brendshme në UK;
- Zbaton hierarkinë e ndarjes së detyrave në vendin e punës;
- Identifikon simbolet kryesore të përdorura në skica dhe projekte teknike;
- Interpretin simbolet teknike në funksion të procesit të punës;
- Zbaton planin e punës;
- Zbaton në kohë grafikun e punimeve;
- Planifikon punimet sipas natyrës së tyre dhe kushteve teknike të zbatimit;
- Organizon punimet sipas planit të punës dhe/ose në varësi të terrenit dhe kushteve të objektit;
- Verifikon paraprakisht vendin ku do të kryhen punimet;
- Kryen procesin e mirëmbajtjes sipas grafikut dhe manualeve;
- Identifikon shiritat sinjalizues që përdoren në punimet në UK, sipas llojit të tyre;
- Zbaton kërkesat teknike për vendosjen e shiritit sinjalizues mbi tubacion;
- Organizon vendin e punës para fillimit të punimeve;
- Ndjek transportimin e mjeteve, materialeve dhe pajisjeve gjatë punës;
- Pastron veshjet e punës, mjetet, veglat, pajisjet dhe vendin e punës para, gjatë dhe pas përfundimit të punës;
- Sistemon veshjet e punës, mjetet, veglat, pajisjet dhe vendin e punës para, gjatë dhe pas përfundimit të punës;
- Njofton në kohë eprorin për defektet apo avaritë e konstatuara;
- Dokumenton punën e kryer;
- Kryen raportim e punës së kryer;
- Bashkëpunon për kryerjen e punës;

NjN-20-III-0591-26 Operimi dhe mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë dhe hidrantëve

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë llojet e burimeve të furnizimit me ujë;
2. Të përshkruajë proceset e mirëmbajtjes së puseve dhe veprave të marrjes;
3. Të dallojë llojet e pompave sipas përdorimit dhe karakteristikave të tyre;
4. Të shpjegojë proceset e mirëmbajtjes së pompave;
5. Të përshkruajë proceset e mirëmbajtjes së stacioneve të pompimit;
6. Të identifikojë llojet e tubacioneve në linjat e transmetimit kryesor;
7. Të shpjegojë rëndësinë dhe procedurat e mirëmbajtjes së tubacioneve në linjat e transmetimit kryesor;
8. Të identifikojë llojet e valvulave;
9. Të shpjegojë rëndësinë dhe procedurat e mirëmbajtjes së valvulave;
10. Të përshkruajë mënyrat e manovrimit të valvulave të komandimit (saraçineskave);
11. Të përshkruajë llojet e rakorderive dhe funksionin e tyre;
12. Të identifikojë llojet e depove dhe rezervuarëve të ujit;
13. Të përshkruajë proceset e mirëmbajtjes së depove dhe rezervuarëve;
14. Të identifikojë llojet e tubacioneve në linjat e shpërndarjes;
15. Të shpjegojë rëndësinë dhe procedurat e mirëmbajtjes së tubacioneve në linjat e shpërndarjes;
16. Të shpjegojë rëndësinë dhe mirëmbajtjen e rakorderive në rrjetin e furnizimit me ujë;
17. Të shpjegojë llojet e defekteve dhe avarive në sistemin e furnizimit me ujë dhe klasifikimin e tyre;
18. Të përshkruajë procedurën e riparimit të defekteve dhe avarive në linjat e transmetimit;
19. Të përshkruajë procedurën e zëvendësimit të pjesëve të dëmtuar në linjat e transmetimit kryesor;
20. Të përshkruajë procedurën e riparimit të defekteve dhe avarive në linjat e shpërndarjes;
21. Të përshkruajë procedurën e zëvendësimit të pjesëve të dëmtuara në linjat e shpërndarjes;
22. Të përshkruajë procedurën e riparimit të defekteve dhe avarive në puse ose vepra marrjeje;
23. Të përshkruajë procedurën e zëvendësimit të pjesëve të dëmtuar në puse ose vepra marrjeje;
24. Të përshkruajë procedurën e riparimit të defekteve dhe avarive hidraulike në depo dhe rezervuarë;
25. Të përshkruajë procedurën e zëvendësimit të pjesëve të dëmtuar në depo dhe rezervuarë;
26. Të përshkruajë procedurat e kontrollit të rrjedhjeve dhe humbjeve fizike të ujit në rrjet;
27. Të identifikojë llojet e testimeve hidraulike pas riparimit;
28. Të shpjegojë rëndësinë e kryerjes së testimeve hidraulike pas riparimit;
29. Të përshkruajë rëndësinë e mirëmbajtjes parandaluese në sistemin e furnizimit me ujë;
30. Të identifikojë llojet e pajisjeve/aparaturave (kamera etj.) për zbulimin e rrjedhjeve.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të zbatojë proceset e mirëmbajtjes së puseve dhe veprave të marrjes;
2. Të zbatojë proceset e mirëmbajtjes së pompave dhe stacioneve të pompimit;
3. Të zbatojë proceset e mirëmbajtjes së tubacioneve dhe rakorderive në rrjetin shpërndarës dhe linjat e transmetimit kryesor;
4. Të kryejë riparimin e defekteve dhe avarive në linjat e sistemit të furnizimit me ujë;
5. Të kryejë kontrollin e rrjedhjeve dhe humbjeve të ujit në rrjet;
6. Të kryejë testimet hidraulike pas riparimit;
7. Të kryejë mirëmbajtjen parandaluese në sistemin e furnizimit me ujë.

Kriteret e vlerësimit

- Identifikon burimet e furnizimit me ujë sipas llojit të tyre;
- Zbaton proceset e mirëmbajtjes së puseve dhe veprave të marrjes;

- Dallon pompat sipas përdorimit dhe karakteristikave të tyre teknike;
- Zbaton procesin e mirëmbajtjes së pompave;
- Zbaton procesin e mirëmbajtjes së stacioneve të pompimit;
- Identifikon tubacionet në linjat e transmetimit kryesor, sipas llojit;
- Zbaton procesin e mirëmbajtjes së tubacioneve në linjat e transmetimit kryesor;
- Identifikon valvulat sipas llojit;
- Zbaton procesin e mirëmbajtjes së valvulave;
- Kryen manovrimin e valvulave të komandimit /saraçineskave, sipas procedurës;
- Identifikon rakorderitë në linjat e furnizimit me ujë, sipas funksionit të tyre;
- Identifikon depot dhe rezervuarët e ujit në sistemin e furnizimit me ujë sipas llojit të tyre;
- Zbaton procesin e mirëmbajtjes së depove dhe rezervuarëve;
- Identifikon tubacionet në linjat e shpërndarjes, sipas llojit;
- Zbaton procesin e mirëmbajtjes së tubacioneve në linjat e shpërndarjes;
- Identifikon defektet dhe avaritë në sistemin e furnizimit me ujë;
- Kryen riparimin e defekteve dhe avarive në linjat e sistemit të furnizimit me ujë, sipas procedurës;
- Zëvendëson pjesët e dëmtuara në linjat e furnizimit me ujë, sipas procedurës;
- Kryen riparimin e defekteve dhe avarive në puse dhe vepra marrjeje, sipas procedurës;
- Zëvendëson pjesët e dëmtuara në puse dhe vepra marrjeje, sipas procedurës;
- Kryen riparimin e defekteve dhe avarive hidraulike në depo dhe rezervuarë, sipas procedurës;
- Zëvendëson pjesët e dëmtuara në depo dhe rezervuarë, sipas procedurës;
- Përdor aparaturat/pajisjet për zbulimin e rrjedhjeve;
- Kryen kontrollin e rrjedhjeve/humbjeve në rrjet sipas procedurës;
- Kryen provën hidraulike pas riparimit, sipas procedurës;
- Kryen mirëmbajtjes parandaluese në sistemin e furnizimit me ujë;

NjN-20-III-0592-26 Instalimi i sistemit të furnizimit me ujë dhe hidrantëve

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë specifikat e terrenit dhe rëndësinë e njohjes së gjurmës së linjës së FU;
2. Të listojë kërkesat teknike për hapjen e kanalit dhe përgatitjen e shtratit të tubacionit të FU;
3. Të shpjegojë mënyrat e shtrimit të tubacioneve të furnizimit me ujë;
4. Të shpjegojë metodat e bashkimit të tubacioneve;
5. Të shpjegojë procesin e instalimit të rakorderive (T, bërryla, fllanxha, nyje mekanike, valvula, ajrues/shkarkues, hidrantë, matës presioni etj.);
6. Të përshkruajë mënyrat e realizimit të intersektimeve në sistemet e FU;
7. Të shpjegojë qëllimin dhe procedurat bazë të shpëlarjes dhe dezinfektimit të linjës së instaluar;
8. Të listojë materialet dhe shtresat që përdoren për mbushjen e kanalit të sistemeve të FU;
9. Të shpjegojë llojet e ujëmatësve (me fushë të thatë, me fushë të njomë, elektronike etj.);
10. Të shpjegojë funksionin e ujëmatësve (bilanci, zonalë dhe të klientit);
11. Të përshkruajë nyjen ujëmatëse, ndërtimin dhe funksionimin e saj;
12. Të përshkruajë metodat dhe teknikat e montimit/çmontimit të nyjes ujëmatëse;
13. Të shpjegojë standardet e ujëmatësve dhe rëndësinë e zbatimit të tyre;
14. Të interpretojë dokumentacionin teknik shoqërues të ujëmatësit;
15. Të shpjegojë llojet dhe përdorimin e rakorderive të ujëmatësit (saraçineska, kundravalvul, reduktor presioni etj.);
16. Të shpjegojë teknikat e montimit të rakorderive të ujëmatësit;
17. Të përshkruajë mënyrat e kryerjes së provës hidraulike të lidhjes së ujëmatësit;

18. Të shpjegojë çfarë është vula e sigurisë, elementët dhe rëndësia e saj;
19. Të shpjegojë teknikat e montimit të vulës së sigurisë;
20. Të shpjegojë rëndësinë e plotësimit të procesverbalit të montimit/çmontimit të ujëmatësit;
21. Të shpjegojë dallimin mes ujëmatësave me turbinë (me një apo shumë currile), ujëmatësave volumetrikë dhe atyre elektromagnetikë/ultrasonikë;
22. Të shpjegojë mënyrën e matjes së vëllimit të ujit dhe klasat e saktësisë (Metrological Class).
23. Të listojë kushtet teknike të montimit, si distanca e kërkuar para dhe pas ujëmatësit (pjesët e drejta) dhe pozicioni i montimit (horizontal/vertikal);
24. Të listojë llojet e hidrantëve;
25. Të shpjegojë dallimin ndërmjet hidrantëve të jashtëm (mbitokësorë dhe nëntokësorë) dhe hidrantëve të brendshëm (muralë);
26. Të listojë llojet e pompave të presionit (Grupit Booster), depozitave rezervë dhe tubave të presionit të lartë;
27. Të identifikojë normat e presionit minimal të kërkuar në kokën e hidrantit dhe prurjen e ujit sipas kategorisë së rrezikut të ndërtesës.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë projektin teknik për instalimin e sistemit të furnizimit me ujë;
2. Të instalojë sistemin e furnizimit me ujë;
3. Të realizojë lidhjen e linjës së re me sistemin ekzistues të furnizimit me ujë;
4. Të instalojë nyjen ujëmatëse;
5. Të instalojë hidrantët;
6. Të kryejë provën hidraulike të sistemit të furnizimit me ujë.

Kriteret e vlerësimit

- Identifikon specifikat e terrenit për gjurmën e linjës;
- Lexon dhe interpreton projektin teknik të furnizimit me ujë;
- Ndjek zbatimin e kushteve teknike për hapjen e kanalit dhe përgatitjen e shtratit të tubacionit;
- Shtron tubacionet e furnizimit me ujë, sipas procedurës dhe kushteve teknike;
- Bashkon tubacionet, sipas procedurës;
- Instalon rakorderitë, sipas procedurës;
- Realizon/mbikëqyr intersektimet sipas rekomandimeve teknike;
- Realizon lidhjen e linjës së re me rrjetin ekzistues të furnizimit me ujë sipas procedurës;
- Zbaton procedurat e shpëlarjes dhe dezinfektimit të linjës së instaluar;
- Përzgjedh ujëmatësit, sipas llojit dhe përmasës;
- Monton/çmonton ujëmatësin, sipas llojit;
- Ndërton nyjen ujëmatëse, sipas kushteve teknike;
- Monton rakorderitë para dhe pas ujëmatësit, sipas procedurës;
- Kryen provën hidraulike të lidhjes së ujëmatësit;
- Vendos vulën e sigurisë, sipas procedurës;
- Plotëson dokumentacionin teknik shoqërues të ujëmatësit;
- Instalon hidrantët, sipas procedurës dhe llojit të tyre.
- Instalon pompat e presionit sipas kushteve teknike;
- Kontrollon presionin në pikat e caktura, sipas procedurës.

NjN-20-III-0593-26 Operimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë përdorimin dhe funksionimin e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura;
2. Të përshkruajë llojet e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura (i kombinuar dhe i ndarë);
3. Të përshkruajë elementët përbërës të rrjetit të kanalizimeve (tuba, bërryla, puseta etj.);
4. Të dallojë llojet e defekteve dhe avarive në rrjetin e kanalizimeve të ujërave të ndotura;
5. Të identifikojë shkaqet kryesore të bllokimeve në rrjetin e kanalizimeve të ujërave të ndotura;
6. Të përshkruajë procedurat e kontrollit të rrjedhjeve/humbjeve fizike në rrjetin e kanalizimeve të ujërave të ndotura;
7. Të shpjegojë mënyrat e riparimit të rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura;
8. Të shpjegojë mënyrat e zëvendësimit të linjave të rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura;
9. Të identifikojë llojet e pusetave të kanalizimeve të ujërave të ndotura, sipas karakteristikave të tyre;
10. Të shpjegojë funksionimin e pusetave të kanalizimeve të ujërave të ndotura.
11. Të përshkruajë procedurat bazë të inspektimit të rrjetit, përfshirë metodat vizuale dhe përdorimin e pajisjeve moderne (p.sh. kamerat e inspektimit).
12. Të shpjegojë rëndësinë e mirëmbajtjes parandaluese në funksionimin e qëndrueshëm të rrjetit të kanalizimeve.
13. Të identifikojë standardet dhe kushtet bazë teknike për ndërtimin dhe funksionimin e rrjeteve të kanalizimeve.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të kryejë kontrollin dhe identifikimin e defekteve dhe avarive në rrjetin e kanalizimeve të ujërave të ndotura;
2. Të përcaktojë vendndodhjen dhe llojin e defektit/avarisë në rrjetin e kanalizimeve të ujërave të ndotura;
3. Të mirëmbajë rrjetin e kanalizimeve të ujërave të ndotura;
4. Të kryejë riparimin dhe zëvendësimin e pjesëve të dëmtuara;
5. Të kryejë provën e funksionimit për pjesët e riparuar apo zëvendësuar.

Kriteret e vlerësimit

- Njihet nëpërmjet skemave ose në terren me rrjetin ekzistues të kanalizimeve të ujërave të ndotura;
- Identifikon rrjetin e kanalizimeve të ujërave të ndotura sipas llojit (i kombinuar dhe i ndarë);
- Kryen kontrollin vizual dhe teknik të rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura për identifikimin e defekteve dhe avarive sipas procedurës;
- Identifikon saktë vendndodhjen e defekteve dhe avarive në rrjet gjatë inspektimit në terren.
- Përcakton saktë llojin e defektit dhe avarive në rrjetin e kanalizimeve (bllokim, çarje, rrjedhje etj.);
- Kryen saktë riparimin e linjave të dëmtuara në rrjetin e kanalizimeve të ujërave të ndotura, sipas procedurës;
- Realizon saktë lidhje të reja për përmirësimin dhe lehtësimin e prurjeve në rrjet;
- Kryen mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura, sipas procedurës;
- Zëvendëson pjesët e dëmtuara të linjave të rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura, sipas procedurës;
- Kontrollon funksionalitetin e pusetave të kanalizimeve të ujërave të ndotura duke evidentuar gjendjen e tyre, sipas procedurës;
- Përdor saktë mjetet dhe pajisjet e punës gjatë kontrollit, pastrimit dhe riparimit të rrjetit;

- Kontrollon rezultatet e ndërhyrjes duke verifikuar funksionimin e rrjetit pas riparimit ose pastrimit.

NjN-20-III-0594-26 Instalimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë specifikat e terrenit në rrjetin e kanalizimeve të ujërave të ndotura;
2. Të përkufizojë rëndësinë e njohjes së gjurmës së linjës së kanalizimeve të ujërave të ndotura;
3. Të përshkruajë kushtet teknike për hapjen e kanalit në rrjetin e kanalizimeve të ujërave të ndotura;
4. Të shpjegojë metodat e bashkimit të tubacioneve me pusetat dhe kushtet teknike përkatëse;
5. Të shpjegojë procedurat e provës hidraulike në segmentet e instaluara;
6. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të kuotave topografike gjatë instalimit të rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura;
7. Të dallojë llojet e shtresave mbushëse dhe mënyrat e vendosjes së tyre në rrjetin e kanalizimeve të ujërave të ndotura;
8. Të shpjegojë vendosjen e shiritit sinjalizues mbi tubacione dhe rëndësinë e tij.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë projektin teknik për instalimin e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura;
2. Të instalojë rrjetin e kanalizimeve të ujërave të ndotura;
3. Të zbatojë kuotat topografike gjatë instalimit të rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura;
4. Të kryejë provën hidraulike në rrjetin e kanalizimeve të ujërave të ndotura.

Kriteret e vlerësimit

- Interpreton saktë vizatimet, skemat dhe detajet teknike të rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura;
- Identifikon specifikat e terrenit për gjurmën e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura;
- Identifikon saktë pikat e shkarkimit dhe lidhjet kryesore në rrjetin e kanalizimeve;
- Ndjek zbatimin e kushtet teknike për hapjen e kanalit në rrjetin e kanalizimeve të ujërave të ndotura;
- Instalon saktë linjat e reja të kanalizimeve sipas projektit dhe kushteve teknike;
- Bashkon tubacionet e shkarkimit me pusetat sipas procedurës;
- Kryen provën hidraulike në segmentet e instaluara, sipas procedurës;
- Zbaton me përpikmëri kuotat topografike gjatë instalimit të rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura;
- Instalon lidhjet e shkarkimeve individuale me linjat dytësore të rrjetit, sipas procedurës;
- Kontrollon saktë pozicionin dhe nivelin e tubacioneve gjatë instalimit;
- Instalon/ndërton pusetat e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura, sipas procedurës;
- Kontrollon shtresat mbushëse dhe mënyrën e vendosjes së tyre në rrjetin e kanalizimeve të ujërave të ndotura;
- Vendos saktë shiritin sinjalizues mbi tubacion sipas kushteve teknike;
- Zbaton rregullat e sigurisë dhe shëndetit gjatë procesit të instalimit në terren.

NjN-20-III-0595-26 Operimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të ujërave të shiut

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë qëllimin dhe rëndësinë e rrjetit të ujrave të shiut;
2. Të listojë elementet përbërëse të rrjetit të ujrave të shiut (tuba, bërryla, pusetat etj.);
3. Të listojë llojet e kunetave, funksionin dhe përdorimin e tyre;
4. Të shpjegojë mënyrat e kontrollit të kunetave;
5. Të përshkruajë metodat e pastrimit të kunetave;
6. Të shpjegojë procedurat e kontrollit të ndërhyrjeve të paligjshme në rrjetin e ujrave të shiut;
7. Të klasifikojë llojet e defekteve dhe avarive në rrjetin e ujrave të shiut;
8. Të shpjegojë teknikat e zëvendësimit të elementeve të rrjetit të ujrave të shiut;
9. Të përshkruajë mënyrat e riparimit të defekteve/avarive në rrjetin e ujërave të shiut;
10. Të përshkruajë llojet e pusetave të ujrave të shiut, funksionimin dhe rëndësinë e tyre;
11. Të shpjegojë funksionin e pusetave të shiut, kasetave absorbuese, kanaleve kulluese (tubacioneve) dhe kanaleve të hapur;
12. Të shpjegojë rolin e zgarave metalike dhe koshave mbledhës për ndalimin e mbetjeve të ngurta;
13. Të shpjegojë kuptimin e prurjes me vetërrjedhje (gravitet) dhe rëndësisë së pjerrësisë (gradientit) teknike;
14. Të përshkruajë funksionin e rezervuarëve mbajtës që shërbejnë për të evituar mbingarkesën e rrjetit gjatë stuhive;
15. Të përshkruajë metodat e pastrimit mekanik dhe me presion uji (hydro-jetting) për heqjen e sedimenteve dhe mbeturinave;
16. Të shpjegojë rëndësinë e planifikimit dhe pastrimit të zgarave dhe pusetave.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të kryejë kontrollin vizual dhe teknik të kunetave dhe pusetave;
2. Të përcaktojë defektet dhe avaritë (bllokim, çarje, rrjedhje, deformim etj.) në rrjet;
3. Të kryejë mirëmbajtjen periodike të rrjetit të ujërave të shiut;
4. Të zbatojë procedurat e riparimit dhe zëvendësimit të elementëve të dëmtuar në rrjetin e ujrave të shiut;
5. Të verifikojë funksionimin e pusetave dhe të rrjetit pas ndërhyrjes.

Kriteret e vlerësimit

- Kryen kontrollin vizual dhe teknik të kunetave, duke identifikuar gjendjen e tyre funksionale sipas kriterëve dhe planit të përcaktuar;
- Pastron saktë kunetat nga papastërtitë dhe sedimentet, duke përdorur mjete dhe pajisje të përshtatshme pa dëmtuar elementet e rrjetit;
- Kontrollon për ndërhyrje të paligjshme në rrjetin e ujrave të shiut, dhe raporton sipas procedurës;
- Përcakton vendndodhjen dhe llojin e defektit/avarisë në rrjetin e ujërave të shiut;
- Përcakton saktë defektin/avarinë (bllokim, çarje, rrjedhje, deformim etj.) sipas llojit dhe ndikimit në rrjet;
- Zbaton saktë procedurat e riparimit të defekteve/avarive në rrjetin e ujërave të shiut;
- Zëvendëson segmentin e dëmtuar të tubacionit, duke siguruar lidhje të qëndrueshme dhe funksionale, sipas procedurës;
- Monton saktë segmentin e tubacionit, duke respektuar procedurat teknike të punës;
- Kontrollon funksionimin e pusetave të ujërave të shiut, duke verifikuar rrjedhjen dhe gjendjen teknike të tyre.
- Raporton në kohë për gjendjen/bllokimin e pusetave;

- Kryen pastrimin mekanik dhe me presion uji (hydro-jetting) për heqjen e sedimenteve dhe mbeturinave nga rrjeti i ujërave të shiut;
- Përdor saktë mjetet dhe pajisjet e punës gjatë operacioneve të mirëmbajtjes dhe riparimit.
- Verifikon rezultatin e ndërhyrjes, duke kontrolluar funksionimin e rrjetit pas riparimit ose zëvendësimit;
- Kontrollon dhe evidenton çarjet, bllokimet dhe pengesat në rrjet duke përdorur pajisjet kamera (CCTV).

NjN-20-III-0596-26 Instalimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të shiut

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë teknikat e montimit të pusetave të rrjetit të ujërave të shiut;
2. Të shpjegojë metodat e shtrimit të tubacioneve të rrjetit të ujërave të shiut dhe kushtet teknike;
3. Të përshkruajë teknikat e montimit të kunetave të rrjetit të ujërave të shiut;
4. Të përshkruajë teknikat dhe mënyrat e mbulimit të tubave të rrjetit të ujërave të shiut;
5. Të shpjegojë rëndësinë e largimit të ujërave të shiut për parandalimin e përmytjeve dhe erozionit;
6. Të shpjegojë rëndësinë e llogaritjes së sipërfaqes mbledhëse dhe intensitetit të rreshjeve për të përcaktuar diametrin e tubacioneve;
7. Të shpjegojë funksionin e ulluqeve, tubacioneve zbritës, pusetave të kontrollit, sifonave të dyshemesë dhe rrjetave mbrojtëse;
8. Të shpjegojë dallimin ndërmjet sistemeve të jashtme (ulluqe) dhe sistemeve të brendshme (për tarraca të rrafshëta);
9. Të shpjegojë metodat e bashkimit hermetik për të parandaluar rrjedhjet në mure ose nëntokë.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të zbatojë projektin teknik për instalimin e rrjetit të ujërave të shiut;
2. Të instalojë rrjetin e ujërave të shiut;
3. Të zbatojë kuotat topografike gjatë instalimit të rrjetit të ujërave të shiut.

Kriteret e vlerësimit

- Interpretin saktë vizatimet, skemat dhe detajet teknike të projektit të instalimit të rrjetit të ujërave të shiut;
- Identifikon specifikat e terrenit për vendosjen e gjurmës së linjës së tubacionit të ujërave të shiut;
- Ndjek zbatimin e kushteve teknike për hapjen e kanalit në rrjetin e ujërave të shiut;
- Kryen matje të sakta të tubave sipas përmasave të kërkuara në projekt;
- Realizon saktë prerjen e tubave sipas masave teknike të përcaktuara;
- Kontrollon nivelimin e linjës gjatë procesit të instalimit;
- Monton saktë tubacionet e rrjetit të ujërave të shiut sipas projektit teknik;
- Bashkon saktë tubacionet duke respektuar procedurat e instalimit;
- Monton saktë pusetat e rrjetit të jashtëm të ujërave të shiut sipas standardeve teknike;
- Monton saktë kunetat e rrjetit të jashtëm të ujërave të shiut duke siguruar funksionimin e tyre.
- Kontrollon pozicionimin dhe funksionalitetin e kunetave dhe pusetave gjatë instalimit;
- Monitoron procesin e mbulimit të linjës për të siguruar që tubacioni nuk dëmtohet gjatë mbushjes;
- Kontrollon zbatimin e kushteve teknike të mbulimit të tubacioneve të rrjetit të ujërave të shiut.
- Përdor saktë mjetet dhe pajisjet e punës gjatë matjes, prerjes dhe montimit të rrjetit të ujërave të shiut;

- Verifikon përputhshmërinë e punimeve me projektin teknik gjatë dhe pas instalimit.

NjN-24-III-0492-26 Sipërmarrje, komunikim dhe edukim karriere

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë parimet bazë të Kodit të Punës dhe legjislacionit përkatës që lidhet me aktivitetin profesional në UK;
2. Të listojë llojet kryesore të dokumentacionit ligjor dhe financiar që përdoret në ushtrimin e aktivitetit (kontrata, fatura, raporte, regjistra);
3. Të përshkruajë format dhe mënyrat e përpilimit, ruajtjes dhe arkivimit të dokumentacionit sipas rregullave përkatëse;
4. Të shpjegojë mënyrat e llogaritjes së nevojave për materiale dhe planifikimit të grafikut të kohës së punës;
5. Të përshkruajë mënyrën e regjistrimit të të dhënave në faturë dhe rëndësinë e saktësisë së tyre;
6. Të shpjegojë mënyrat dhe elementët kryesorë të përgatitjes së një oferte për punime ose shërbime;
7. Të listojë llojet kryesore të raportimeve financiare (raporte shpenzimesh, të ardhurash, balance të thjeshta);
8. Të përshkruajë mënyrat e informimit nga tregu në lidhje me çmimet dhe cilësinë e mjeteve, materialeve dhe pajisjeve të punës;
9. Të përshkruajë elementët bazë të llogaritjes së kostos për mjete, materiale dhe pajisje pune;
10. Të identifikojë komponentët e kostos (kosto direkte dhe indirekte);
11. Të shpjegojë mënyrën e përlllogaritjes së kostos së prodhimit për një produkt;
12. Të dallojë llojet kryesore të faturave (faturë tatimore, faturë e thjeshtë, faturë shoqëruese);
13. Të përshkruajë elementet përbërëse të një fature (data, përshkrimi, sasia, çmimi, TVSH-ja);
14. Të shpjegojë procedurën e plotësimit korrekt të faturave;
15. Të përshkruajë përmbajtjen e një oferte për punime/shërbime;
16. Të identifikojë elementet kryesore të një oferte (përshkrimi i punës, çmimi, afatet, kushtet);
17. Të shpjegojë rëndësinë e përgatitjes së ofertave për klientët;
18. Të përshkruajë konceptin e inventarit dhe rëndësinë e tij në biznes;
19. Të identifikojë mënyrat e dokumentimit të inventarit (regjistra, lista, sisteme elektronike);
20. Të shpjegojë parimet bazë të menaxhimit të inventarit;
21. Të përshkruajë procedurat e furnizimit me materiale dhe pajisje;
22. Të identifikojë dokumentacionin e nevojshëm për furnizim (porosi, kontrata, fatura);
23. Të shpjegojë hapat kryesorë të procesit të furnizimit;
24. Të dallojë mënyrat e blerjes së mjeteve dhe materialeve (blerje direkte, me porosi, online);
25. Të përshkruajë kriteret për përzgjedhjen e furnitorëve;
26. Të shpjegojë elementet e llogaritjes së çmimit për shërbimet/punimet e ofruara;
27. Të identifikojë faktorët që ndikojnë në çmim (kostoja, tregu, konkurrenca, cilësia);
28. Të përshkruajë konceptin e fitimit dhe marzhit të fitimit;
29. Të dallojë llojet e dokumenteve për dorëzimin e punimeve/shërbimeve (procesverbal, fletë-dorëzim, faturë);
30. Të përshkruajë përmbajtjen e dokumenteve të dorëzimit;
31. Të përshkruajë konceptin e marketingut dhe rolin e tij në biznes;
32. Të identifikojë teknikat bazë të marketingut (promovimi, reklama, komunikimi me klientin);
33. Të shpjegojë rëndësinë e kënaqësisë së klientit dhe imazhit të biznesit;
34. Të përshkruajë mënyrat e promovimit të shërbimeve (rrjete sociale, rekomandime, ekspozim);

35. Të përshkruajë mënyrat e analizimit të vetvetes në aspektin profesional (pikat e forta, dobësitë, aftësitë dhe interesat);
36. Të shpjegojë rëndësinë e vetëvlerësimit në përmirësimin e performancës në punë;
37. Të identifikojë metodat e zhvillimit profesional (mësim gjatë gjithë jetës, trajnime, praktikë, mentorim);
38. Të përshkruajë konceptin e zhvillimit të karrierës dhe fazat e tij;
39. Të shpjegojë rëndësinë e planifikimit të karrierës në fushën ujësjellës-kanalizimeve;
40. Të identifikojë aftësitë e nevojshme për zhvillim profesional në tregun e punës;
41. Të përshkruajë teknologjitë bashkëkohore të përdorura në proceset e punës (softuerë dizajni, pajisje digjitale);
42. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të teknologjisë në rritjen e cilësisë dhe efikasitetit të punës;
43. Të përshkruajë mënyrat e transmetimit të njohurive dhe eksperiencës tek bashkëpunëtorët në vendin e punës;
44. Të shpjegojë rëndësinë e komunikimit profesional në transferimin e njohurive teknike;
45. Të identifikojë mënyrat e aplikimit të teknikave të reja në proceset e punës;
46. Të përshkruajë rëndësinë e inovacionit në përmirësimin e produkteve dhe shërbimeve;
47. Të dallojë llojet e panairëve profesionale dhe ekspozitave në fushën ujësjellës - kanalizime;
48. Të shpjegojë rolin e panairëve dhe ekspozitave në promovimin e produkteve dhe krijimin e kontakteve profesionale;
49. Të identifikojë llojet e trajnimeve profesionale (fillestare, të avancuara, specializuese);
50. Të përshkruajë rëndësinë e kurseve teknike në përmirësimin e aftësive praktike dhe teorike;
51. Të shpjegojë konceptin e të mësuarit gjatë gjithë jetës (lifelong learning);
52. Të përshkruajë rëndësinë e përshtatjes me ndryshimet teknologjike në profesion;
53. Të identifikojë burimet e informacionit për zhvillim profesional (internet, manuale, kurse, kolegë, institucione);
54. Të shpjegojë rëndësinë e punës në ekip në zhvillimin profesional dhe shkëmbimin e eksperiencave;
55. Të përshkruajë mënyrat e përmirësimit të vazhdueshëm të aftësive personale dhe profesionale;
56. Të identifikojë mundësinë e punësimit dhe zhvillimit në sektorin e ujësjellës – kanalizimeve;
57. Të përshkruajë konceptin e komunikimit dhe metodat kryesore të tij në një mjedis profesional;
58. Të shpjegojë parimet bazë të punës në grup dhe rëndësinë e bashkëpunimit në realizimin e detyrave;
59. Të dallojë rregullat bazë të komunikimit verbal dhe joverbal;
60. Të shpjegojë parimet e Kodit të Etikës dhe rëndësinë e zbatimit të tij në vendin e punës;
61. Të përshkruajë metodat bazë të zgjidhjes së problemeve dhe rolin e mendimit kritik në situata pune;
62. Të identifikojë bashkëpunëtorët kryesorë në veprimtarinë profesionale dhe rolin e secilit;
63. Të shpjegojë përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në komunikimin profesional;
64. Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit korrekt të terminologjisë profesionale në fushën e ujësjellës-kanalizimeve;
65. Të shpjegojë rëndësinë e ruajtjes së të dhënave konfidenciale dhe mbrojtjes së informacionit;
66. Të përshkruajë rëndësinë e respektimit të parimeve të barazisë dhe mosdiskriminimit (gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.) në mjedisin e punës.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë legjislacionin e fushës dhe rregullat bazë të punës në aktivitetin profesional;
2. Të kryejë llogaritje të kostove, çmimeve, materialeve etj. për punime ose shërbime;

3. Të kryejë procedurat e furnizimit;
4. Të përgatitë oferta për punime ose shërbime;
5. Të plotësojë dokumentet e dorëzimit dhe inventarit të mallrave dhe shërbimeve;
6. Të kryejë marketingun dhe promovimin e shërbimeve UK;
7. Të zbatojë metoda të zhvillimit profesional;
8. Të zbatojë etikën profesionale dhe komunikimin profesional në vendin e punës;
9. Të bashkëpunojë/punojë në grup në mënyrë efektive;
10. Të përdorë komunikimin digjital dhe dokumentacionin profesional;
11. Të respektojë rregullat e konfidencialitetit dhe sigurisë së informacionit.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton legjislacionin e punës në situata reale;
- Organizon dhe arkivon dokumente ligjore (kontratë, faturë, raport), sipas rregullave;
- Llogarit saktë sasinë e materialeve për një punim;
- Llogarit saktë koston totale të produktit;
- Përcakton çmimin dhe marzhin e fitimit duke analizuar faktorët që ndikojnë në çmim;
- Plotëson fatura me të gjithë elementët (data, sasia, çmimi, TVSH-ja);
- Regjistron të dhënat pa gabime;
- Harton një ofertë për punime/shërbime duke përfshirë elementet kryesore (përshkrim, çmim, afate, kushte etj.);
- Harton raporte të thjeshta financiare (shpenzime, të ardhura) duke paraqetur të dhëna të sakta dhe të strukturuar;
- Kryen analizë të çmimeve dhe cilësisë së materialeve në treg;
- Përzgjedh furnitorë sipas kriterëve përkatës;
- Ndjek procedurat e furnizimit (porosi, kontratë, faturë);
- Regjistron materialet në lista dhe regjistra;
- Kryen procedurat e blerjeve;
- Plotëson me korrektësi dokumente të dorëzimit (procesverbal, fletë-dorëzim);
- Propozon mënyra konkrete promovimi duke përdorur teknika promovimi (rrjete sociale, reklama);
- Jep vlerësim realist për veten;
- Identifikon pikat e forta dhe dobësitë personale në punë;
- Harton një plan të thjeshtë për përmirësim personal;
- Transmeton në kohë dhe në mënyrë të qartë teknika të reja duke mbështetur bashkëpunëtorët;
- Zgjedh dhe ndjek trajnime të përshtatshme në funksion të zhvillimit të vet profesional;
- Zbaton rregullat e etikës në punë dhe komunikim;
- Jep shembuj konkretë nga situata pune duke përdorur metodat e komunikimit verbal, joverbal, shkresor dhe e-mail;
- Komunikon me kolegët dhe bashkëpunëtorët duke përdor terminologji bazë profesionale;
- Merr pjesë aktive në detyrë në grup;
- Respekton rolet e anëtarëve të grupit;
- Ndhmon dhe bashkëpunon me të tjerët;
- Ndjek udhëzimet dhe kontribuon në procesin e vendimmarrjes;
- Zgjidh konflikte të thjeshta në mënyrë pozitive;
- Përdor e-mail, mesazhe profesionale ose platforma digjitale;
- Përdor terminologji profesionale në komunikimin digjital;
- Harton përshkrime pune me gjuhë profesionale;
- Zbaton rregullat për ruajtjen e informacionit konfidencial në punë (klientë, çmime, projekte);

- Zbaton rregulla të mbrojtjes së informacionit (fjalëkalime, mosndarje pa leje, ruajtje dokumentesh etj.);
- Respekton parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit;
- Paraqet sjellje korrekte në situata diskriminimi duke respektuar parimet e barazisë dhe respektit.

NjN-20-III-0597-26 Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në ujësjellës kanalizime

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë standardet dhe legjislacionin shqiptar për rregullat e sigurimit teknik në vendin e punës;
2. Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të manualeve të mjeteve dhe pajisjeve të punës;
3. Të identifikojë procedurat dhe mjetet për dhënien e ndihmës së parë në rast aksidenti;
4. Të interpretojë sinjalistikën dhe shenjat paralajmëruese në mjedisin e punës;
5. Të përshkruajë procedurat e evakuimit në raste emergjence;
6. Të shpjegojë përdorimin dhe funksionin e pajisjeve të mbrojtjes nga zjarri (MZSH);
7. Të përshkruajë masat e sigurisë gjatë përdorimit të solucioneve me përmbajtje kimike;
8. Të shpjegojë konceptin dhe karakteristikat e zhvillimit të qëndrueshëm;
9. Të përshkruajë rregullat e mbrojtjes së mjedisit për ndarjen dhe menaxhimin e mbetjeve;
10. Të identifikojë rregulloret përkatëse për depozitimin e mbetjeve;
11. Të shpjegojë rëndësinë e identifikimit dhe raportimit të mosfunksionimit të mjeteve dhe pajisjeve të punës;
12. Të përshkruajë rregullat e sigurisë për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve;
13. Të identifikojë pajisjet mbrojtëse personale dhe funksionin e tyre në sigurinë në punë;
14. Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të funksionalitetit të pajisjeve mbrojtëse personale;
15. Të përshkruajë pajisjet e thjeshta për kontrollin e rrjetit elektrik;
16. Të dallojë llojet e tabelave të kufizimit dhe sinjalistikës për sigurinë teknike;
17. Të shpjegojë protokollet e duhura të veprimit në raste të gjendjeve të jashtëzakonshme;
18. Të shpjegojë rëndësinë e vendeve ku derdhet rrjeti (lumenj, liqene ose impiante trajtimi) dhe rregullat mjedisore për shkarkimin;
19. Të identifikojë metodat për parandalimin e ndotjes së ujërave nëntokësore gjatë riparimit të defekteve;
20. Të shpjegojë rregullat e sigurisë për punën në hapësira të mbyllura (puseta, tunele) dhe rreziqet nga gazrat toksikë (si H₂S ose metani);
21. Të shpjegojë rëndësinë e stabilitetit të dherave dhe blindimin e kanaleve (për të parandaluar shembjet);
22. Të shpjegojë procedurat për izolimin e energjisë përpara përdorimit të pajisjeve;
23. Të shpjegojë rrezikun e presionit të lartë dhe procedurat e shkarkimit të sigurt të ajrit dhe ujit përpara hapjes së linjave;
24. Të shpjegojë protokollet e higjienës për parandalimin e kontaktit me ujërat e ndotura (rreziku biologjik: bakteret, viruset).

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë, duke përdorur saktë manualët, PPE dhe procedurat e punës;
2. Të zbatojë procedurat e emergjencës, përfshirë ndihmën e parë, evakuimin dhe përdorimin e pajisjeve kundër zjarrit;
3. Të zbatojë sinjalistikën dhe masat e sigurisë në mjedisin e punës;

4. Të zbatohet masat e sigurisë gjatë punimeve hidraulike, përfshirë izolimin e energjisë dhe shkarkimin e presionit;
5. Të zbatohet rregullat e sigurisë në kushte të rrezikshme pune, përfshirë hapësirat e mbyllura, stabilitetin e dherave dhe rreziqet biologjike;
6. Të zbatohet rregullat e mbrojtjes së mjedisit, duke menaxhuar mbetjet dhe parandaluar ndotjen e ujërave nëntokësore.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton saktë standardet dhe legjislacionin e sigurisë teknike në vendin e punës gjatë veprimtarive praktike;
- Përdor saktë manualët e mjeteve dhe pajisjeve gjatë punës sipas udhëzimeve të tyre;
- Zbaton saktë procedurat e ndihmës së parë në raste aksidenti;
- Interpretin me korrektësi sinjalistikën dhe shenjat paralajmëruese në mjedisin e punës;
- Zbaton saktë procedurat e evakuimit në raste emergjence sipas planit të sigurisë;
- Përdor saktë pajisjet e mbrojtjes nga zjarri (MZSH) në situata të simuluar;
- Zbaton masat e sigurisë gjatë përdorimit të solucioneve kimike sipas udhëzimeve teknike;
- Zbaton parimet bazë të zhvillimit të qëndrueshëm në veprimtari praktike;
- Menaxhon saktë mbetjet sipas rregullave të mbrojtjes së mjedisit;
- Zbaton saktë rregulloret për depozitimin e mbetjeve në vendin e punës;
- Raporton saktë mosfunksionimin e mjeteve dhe pajisjeve sipas procedurës së brendshme;
- Zbaton rregullat e sigurisë për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve në vendin e punës;
- Përdor saktë pajisjet mbrojtëse personale (PPE) sipas llojit të rrezikut;
- Kontrollon funksionalitetin e PPE përpara përdorimit;
- Identifikon në kohë defektet e PPE;
- Interpretin saktë tabelat e sinjalistikës dhe kufizimeve të sigurisë;
- Zbaton protokollet e veprimit në situata të gjendjeve të jashtëzakonshme sipas skenarëve praktikë;
- Zbaton saktë rregullat mjedisore për shkarkimin e ujërave në lumenj, liqene, det ose përrua;
- Zbaton masat e parandalimit të ndotjes së ujërave nëntokësore gjatë riparimeve të defekteve në rrjet;
- Zbaton rregullat e sigurisë për punë në hapësira të mbyllura (puseta, tunele) duke identifikuar rreziqet nga gazrat toksikë;
- Zbaton procedurat për stabilitetin e dherave dhe përdor blindim të kanaleve për parandalimin e shembjeve;
- Kryen izolimin e energjisë përpara përdorimit të pajisjeve sipas procedurës së sigurisë;
- Zbaton procedurat e shkarkimit të sigurt të presionit (ujë/ajër) përpara hapjes së linjave;
- Zbaton protokollet e higjienës për të shmangur kontaktin me ujërat e ndotura dhe rreziqet biologjike.

Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:

Nr.	Njësi të nxëni	Peshat në %	Kodet
1	Bazat e hidraulikës në ujësjellës kanalizime	10	NjN-20-III-0586-26
2	Bazat e topografisë	3	NjN-20-III-0587-26
3	Materialet në hidraulikë	6	NjN-20-III-0588-26
4	Mjetet, veglat, pajisjet dhe makineritë e punës në hidraulikë	9	NjN-20-III-0589-26

5	Planifikimi dhe organizimi i punës në ujësjellës kanalizime	2	NjN-20-III-0590-26
6	Operimi dhe mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë dhe hidrantëve	14	NjN-20-III-0591-26
7	Instalimi i sistemit të furnizimit me ujë dhe hidrantëve	15	NjN-20-III-0592-26
8	Operimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura	9	NjN-20-III-0593-26
9	Instalimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura	12	NjN-20-III-0594-26
10	Operimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të ujërave të shiut	8	NjN-20-III-0595-26
11	Instalimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të shiut	8	NjN-20-III-0596-26
12	Sipërmarrje, komunikim dhe edukim karriere	2	NjN-24-III-0492-26
13	Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në ujësjellës kanalizime	2	NjN-20-III-0597-26
	Total	100	

Modalitetet e vlerësimit

Me vlerësim kuptojmë procesin gjatë të cilit mblidhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së një rezultati të nxëni (RN), mbi bazën e kriterëve të caktuar;

Për vlerësimin mund të përdoret një shumëllojshmëri metodash standarde dhe inovative;

Individi i nënshtrohet vlerësimit të vazhduar, përmbledhës dhe vlerësimit përfundimtar për kualifikimet formale që ofrohen nga ofrues të akredituar;

Individi vlerësohet për shkallën e përvetësimit të kompetencave të përgjithshme dhe profesionale, të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën përkatëse dhe vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së RN për realizimin e tërësisë së proceseve duke mbajtur evidenca për qëllime dokumentimi;

Realizimi i pranueshëm konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të specifikuar; Dhënia e rezultatit të vlerësimit bëhet sipas kuadrit ligjor në fuqi;

Kompetencat e përgjithshme vlerësohen të integruara si pjesë e vlerësimit të njësive të të nxënit;

Individit i lind e drejta të certifikohet për njësitë të nxëni specifike, si një kualifikim i pjesshëm sipas kuadrit ligjor në fuqi;

Informacion shtesë

Kualifikimet e plota ose të pjesshme profesionale mund të përftohen nëpërmjet këtyre formave:

- ndjekjes së arsimit profesional me bazë shkollën;
- ndjekjes së kurseve profesionale, ku përfshihen edhe praktikat profesionale në ndërmarrje apo forma të tjera të mësimnxënies praktike;
- regjistrimit si nxënës, duke u punësuar në një ndërmarrje (forma e dyfishtë);
- njohjes së të nxënit të mëparshëm informal dhe joformal;
- njohjes së të nxënit të përfutur jashtë vendit;

dh) formave të tjera të përcaktuara me ligj;

SHËNIM

Shpjegime të kodit të kualifikimit: V6-III-26

V - Shkronja që identifikon fushën e kualifikimit profesional

6 - Numri që identifikon profilin e kualifikimit përkatës

III - Shifra që identifikon nivelin sipas KSHK

26 - Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar kualifikimi profesional

Shpjegime të kodit të njësisë së të nxënit: NjN-20-III-0586-26

NjN – Shkronjat që tregojnë se kodi i referohet Njësive të të Nxënit

20 – Numri që identifikon fushën e Njësisë së të Nxënit

III – Shifra që tregon nivelin e Njësisë së të Nxënit në strukturën e KSHK

0586 – Numri rritës progresiv që tregon gjendjen e Njësive të të Nxënit në ditën e hartimit përkatës

26 – Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar Njësia e të Nxënit